



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.09.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:32 dhe mbaroi në orën 13:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Marçela Shehu*** dhe z. ***Dritan Hallunaj***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Staf administrativ i KLGJ-së; Këshilltarë dhe Media KLGJ.*
5. *Katerina Çela.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

...Siç jeni në dijëni, në rendin e ditës janë katër çështje.

Me kërkesë nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për shkak të urgjencës që ka, kërkohet që të përfshihet në rendin e ditës një çështje tjetër që ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

A jeni dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Shtohet në rendin e ditës çështja “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Atëherë, pa humbur kohë, fillojmë me rendin e ditës sipas çështjeve.

Çështja e parë ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, z. {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit z. Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 08.09.2022 është depozituar një kërkesë me shkresë protokolluar me nr.{...} prot., dhe shkresën me nr.4677/1 datë 12.09.2022 të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi. Gjyqtari z. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 03.07.1989.

Me vendim nr. 7, datë 08.02.1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar ushtarak në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, gjykatë në të cilën vijon të ushtrojë funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 26 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi

Në dorëheqje z. {...} si motiv ka parashtruar se: “Për më shumë se 26 vitesh kam ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, funksion të cilin jam përpjekur ta përmbush maksimalisht me përkushtim profesional e ndershmeri në kryerjen e tij. Vitet e fundit puna si gjyqtar është bërë shumë e lodhshme dhe e papërbalueshme për shkak të ngarkesës dhe shkaqeve të tjera objektive që kanë shoqëruar zbatimin e Reformës në Drejtësi. Për shkaqe të disa problemeve shëndetësore që sipas mjekëve janë pasoje e profesionit si gjyqtar dhe nevojës që ti përkushtohem më shumë shëndetit tim dhe familjes, bazuar në nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, praqes dorëheqjen nga statusi i magjistratit si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke kërkuar nga Këshilli deklarimin e mbarimit të statusit tim si magjistrat me vendim të Këshillit”.

Në kushtet kur vullneti i magjistratit prevalon mbi çdo shkak tjetër dhe në kushtet kur ky vullnet është qartësuar pranë institucionit duke u paraqitur në formë shkresore, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është paraqitur ky projektvendim, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.10.2022.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse nuk ka ndonjë diskutim nga kolegët?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.10.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.09.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:32 dhe mbaroi në orën 13:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Marçela Shehu** dhe **z. Dritan Hallunaj**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së; Këshilltarë dhe Media KLGJ.

5. Katerina Çela.

6. {...}, magjistrat.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës, që ka të bëjë me projekt-aktin lidhur me përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}.

Atëherë, përpara se të fillojë relatimi i projekt-aktit, gjyqtari {...} ka bërë kërkesë përpara Këshillit lidhur me prezencën e tij në shqyrtimin e këtij projekt-akti duke parashtruar edhe kundërshtime mbi projek-aktin e propozuar nga Komisioni.

Nga ana e administratës të bëhet e mundur thërritja e gjyqtarit.

(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtari {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje z. {...}!

Atëherë, siç jeni në dijëni në lidhje me çështjen që merret në shqyrtim sot, bëhet fjalë për një propozim nga ana e Komisionit të Vlerësimit Profesional dhe Etikës, mbi përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016.

Atëherë, siç e lejon edhe procedura, fjalën fillimisht do ia jap relatores së projekt-aktit dhe më pas fjala do t’ju jepet juve, pasi të dëgjoni relatoren, ku shkurtimisht do fokusoheni vetëm në ato gjëra të cilat nuk i keni parashtruar me shkrim (sepse i kemi marrë me shkrim të gjitha kundërshtimet) dhe do donim nëse keni ndonjë gjë përtej atyre të shkruara.

Zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në aktet nënligjore që kanë plotësuar skemën e vlerësimit për gjyqtarët, me vendimin nr. 239, datë 30.06.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët për të cilët ka filluar kjo procedurë është edhe z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Dua të theksoj që në momentin kur Këshilli vendos fillimin e procedurës së vlerësimit për efekt të gradimit, ne kemi vetëm dosje të dërguara nga organet e rivlerësimit të cilat nuk janë vlerësuar për përmbajtjen e akteve, pra ne fillojmë një procedurë vlerësimi, caktojmë relatorin dhe është relatori i cili pastaj merr vendim lidhur me vijueshmërinë e procedurës së vlerësimit.

Nëpërmjet këtij vendimi, bazuar në procedurën e shortit, për vlerësimin e gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2013–2016, është përzgjedhur relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Në datën 30.06.2022, bazuar në nenin 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, i është njoftuar gjyqtarit vendimi për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar bashkë me emrat e vlerësuesve, nëpërmjet postës elektronike. Gjyqtari ka konfirmuar marrjen dijëni dhe është shprehur se është dakord me vlerësuesit.

Në vijim të procedurës, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, bazuar në parashikimet e nenit 24, të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020 “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, ka hartuar procesverbalin për pasqyrimin e çështjeve dhe vendimeve që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit.

Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtarit, ka rezultuar se: Z. {...} në periudhën tetor 2012 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Me dekretin e Presidentit të Republikës me datë 23.06.2016 ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, z. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në dy periudha:

(i) Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh;

(ii) Funkcionin e gjyqtarit për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë (brenda periudhës së rivlerësimit kalimtar).

Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin i kohës nr.8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 parashikonte se:

“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

- a) Një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;
- b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;
- c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (e konsideruar si periudha e stazhit profesional).

Programi teorik sipas germës a) të nenit 14 është i përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa viti praktik dhe viti i stazhit profesional zhvillohen sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror..”.

Në vijim, në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohej se:

“Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magjistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.”

Në nenin 19/1 parashikohej se: “Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë: a) shkëlqyeshëm; b) shumë mirë; c) mirë; ç) mjaftueshëm; d) pamjaftueshëm. Rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Ndërsa, lidhur me vlerësimin e vitit të tretë (pra bëhet fjalë për stazhin profesional aktiv të kandidatit për gjyqtar), në nenin 20, paragrafi i parë i ligji, parashikohej se: “Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit.” Dua të theksoj që në ndryshim nga ligji aktual, ligji i mëparshëm, por edhe kandidatët për gjyqtarë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës sipas ligjit të mëparshëm, e merrnin statusin në përfundim të vitit të dytë. Pra në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës ata ishin kandidatë në stazh profesional aktiv në këtë shkollë, por e kishin marrë statusin e gjyqtarit.

Po ashtu në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, në nenin 27 të saj, në fuqi në momentin kur gjyqtari ka përfunduar stazhin e tij profesional, parashikohej se:

“Pas përfundimit të stazhit paraprofesional, kandidatët i nënshtrohen stazhit profesional, i cili konsiston në pjesëmarrjen aktive në ndjekjen e çështjeve më pak të ndërlikuara nën udhëheqjen e një gjyqtari ose prokurori.

Në fund të stazhit profesional bëhet vlerësimi i akteve dhe vendimeve të përpiluara nga kandidatët gjatë vitit. Secili prej tyre depoziton dosjen me materialet në sekretarinë shkencore në afatin e caktuar. Ndarja e dosjeve bëhet me short dhe vlerësimi bëhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi përfundimtar i vitit të tretë bëhet nga Këshilli Pedagogjik.”

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të cituar, referuar më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës (sipas ligjit të mëparshëm), ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj

periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshkruar vlerësimi profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtari {...} e ka pasur statusin e gjyqtarit edhe gjatë praktikës profesionale.

Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtë periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të 3-të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të 3-të sipas ligjit të kohës, ka pasur statusin e gjyqtarit, i vetmi organ që ka pasur kompetencën e vlerësimit etik dhe profesional të tij ka qenë Shkolla e Magjistraturës, vlerësim mbi të cilin është bërë edhe pikëzimi dhe renditja e tij me rastin e diplomimit nga kjo Shkollë. Dhe mbi bazën e këtij vlerësimi është bërë edhe renditja dhe caktimi i gjyqtarit në pozicionin e tij sot, pozicioni i lirë i përhershëm.

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet: “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo “mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerësimit lidhur më to.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit “Për Statusin”, vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur. Me termin “Ligj” do të kuptohet jo vetëm Ligji për Statusin, por edhe ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence të organit, gradimin e gjyqtarëve, sikundër është ligji nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili për periudhën tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, përcaktonte si organ kompetent Shkollën e Magjistraturës, për të bërë vlerësim etik dhe profesional për gjyqtarët në vitin e tretë të programit të formimit fillestar.

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të z. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013–2016, rezulton se ai ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për periudhën 23.06.2016 deri në datën 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë. Edhe nëse vitin 2016 do të konsiderohet vit të plotë pune për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja e detyrës së gjyqtarit përkon me 6 muaj e 7 ditë.

Në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, parashikohet se:

“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar.

2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat..”.

Duke u ndalur tek kjo dispozitë, Këshilli, edhe kur ka miratuar programet e vlerësimit të gjyqtarëve çdo vit sipas një kalendari vlerësimesh, ka konsideruar që për kandidatët dhe për gjyqtarët të cilët kanë filluar punë menjëherë pasi kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, vlerësimi do të fillojë pasi ata të kenë bërë tre vite punë, pavarësisht ndërprerjeve që mund të kenë brenda periudhës trevjeçare por magjistrati, që të vlerësohet, duhet patjetër që të ketë tre vite përvojë profesionale.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5, parashikohet se:

1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin....

3. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.”

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për z. {...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, procedura e vlerësimit etik dhe profesional e filluar për periudhën 3-vjeçare që i përket viteve 2013-2016, nuk mund të vazhdojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1-vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtari pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda periudhës së vlerësimit 2013-2016, rezulton se, objekti për të cilin ka filluar procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është i pamundur të realizohet dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure vlerësimi nuk mund të vazhdojë, pasi gjyqtari nuk ka ushtruar detyrën për një kohë të mjaftueshme gjatë periudhës së vlerësimit, për të mundësuar vlerësimin e tij etik dhe profesional.

Në vijim, në cilësinë e relatores, vendimit të miratuar edhe nga ana e Komisionit, kemi zbatuar nenin 97, pika 3 të K.Pr.A., duke qenë se është një ligj i cili thirret për zbatim në rastet kur ligji për organet e qeverisjes nuk ka një dispozitë të shprehur, në të cilin parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Në rastin konkret, me konstatimin e mungesës së kushteve ligjore për të përcaktuar si periudhe të plotë vlerësimi, periudhën 3-vjeçare 2013-2016, për z. {...}, realizimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, rezulton të jetë objektivisht i pamundur. Për pasojë vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për vitin 2013-2016, nuk mund të vazhdojë. Ndërkohë që për zotën {...} ka filluar

menjëherë procedura e vlerësimit etik dhe profesional periodike që i përket viteve 2017-2019.

Për këtë arsye, në cilësinë e relatores kam përgatitur projektvendimin, në pikën e parë të së cilit gjendet parashikimi për përfundimi pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit {...}, për periudhën 2013-2016, për shkak se objekti për të cilën ka nisur kjo procedurë është i pamundur të realizohet, sepse koha e ushtrimit të detyrës nga gjyqtari, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën 2 dhe në pikën 3 është parashikuar njoftimi i vendimit gjyqtarit si dhe e drejta e ankimit ndaj një akti administrativ individual të Këshillit në rast se ky projekt-akt i propozuar do të miratohet.

Në kuadër të respektimit të parimit të dëgjimit dhe të njohjes së gjyqtarit me të gjithë ecurinë dhe fazat e procedurës së vlerësimit si dhe vlerësimin e bërë nga ana e relatorit, gjyqtari është njohur paraprakisht me relacionin dhe ka paraqitur kundërshtimet e tij. Kundërshtimet i janë vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve, gjithsesi gjyqtari e ka nisur edhe në e-mail personal të gjithë anëtarëve kundërshtimet e tij, sot na e keni nisur edhe kopje të skanuar... Po, në e-mail zyrtar. Sot na e keni nisur edhe në kopje të skanuar. Ne i kemi. Gjithsesi, fjalën e keni ju. Që të mos biem në përsëritje dhe unë të mos përsëris ato që do thoni.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, zoti {...}, shkurtimisht çfarë keni ndonjë gjë për të shtuar mbi ato që ju keni parashtruar me shkrim.

{...}: Po, faleminderit zonja Kryetare!

E nderuar Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Të nderuar anëtarë!

Shkurtimisht, krejt shkurt, duke qenë se jeni njohur me materialin, me kundërshtimet e mia në lidhje me raportin e përgatitur nga relatorja, së pari, theksoj se Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndjekin qëllime të ndryshme. Nuk janë komplementare të njëri-tjetrit. Nëse do ishin komplementare të njëri-tjetrit atëherë mund të shtrohej për diskutim. Bie dakord patjetër, sepse është konstatim ligjor, fakti

që viti i tretë i Shkollës së Magjistraturës (stazhi profesional) është pjesë integrale e formimit fillestar e Shkollës së Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës ka dy shtylla kryesore, formimin fillestar, formimin vazhdues. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka qëllimet e tij në lidhje me veprimtarinë e tij kushtetuese dhe ligjore. E thënë shkurt, po të mos ishte neni 21 i ligjit të kohës për Shkollën e Magjistraturës do të isha dakord me relacionin e përgatitur nga relatori, por ka një dispozitë ligjore që e vendos kandidatin për gjyqtar gjatë periudhës së stazhit profesional në pozita të barabarta me magistratin në detyrë. Për sa kohë që ka një dispozitë ligjore që e barazon gjyqtarin stazhier me gjyqtarin në detyrë, atëherë, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për gjyqtarin në detyrë duhet të jenë edhe për gjyqtarin stazhier.

Në rregullore e keni pranuar, e keni vendosur që duhet të jetë jo më pas se 1 vit. Mendoj se të dyja periudhat duhet të përfshihen në periudhën e vlerësimit nga ana e këtij Këshilli.

Kaq kam për të thënë.

Neni 21 e përcakton qartë. Po të mos ishte kjo dispozitë, do të isha dakord me relacionin.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Mund të vazhdoni, për të lejuar Këshillin që të marri vendim.

{...}: Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari {...}.)

Naureda Llagami: Po zonja Ukperaj!

Lidhur me çfarë parashtrroi gjyqtari.

Brikena Ukperaj: Atëherë, në fakt, gjyqtari ka bërë kundërshtime më të gjera. Ka pretenduar cenim të parimit të sigurisë juridike, të barazisë së trajtimit para ligjit; ka pretenduar që diskriminohet për shkak të karrierës së tij dhe sot të gjitha kundërshtimet e gjyqtarit qëndrojnë në faktin që e pranon që ka më pak se një vit punë si gjyqtar pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, por pretendon që nëse kjo periudhë i

bashkohet me periudhën kur ai ka ushtruar efektivisht detyrën e gjyqtarit gjatë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, atëherë periudha është më e gjatë dhe mund të gradohet.

Në fakt, ligji i kohës parashikon gjatë periudhës së stazhit profesional, kandidatët gëzojnë të drejta dhe kanë detyrime njësoj si magjistratët, por po ky ligj parashikon që për vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, vlerësimin e kandidatit e bën Shkolla e Magjistraturës. Pra i ka të përcaktuara ky ligj. Ky ligj përcakton gjithashtu, sikundër ndryshe arsyeton gjyqtari në kundërshtimet e veta, që edhe në rastet e procedimit disiplinor, nuk ka qenë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka qenë Shkolla e Magjistraturës.

Nuk ka diskriminim të gjyqtarit, sepse të gjithë gjyqtarët që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në të njëjtin vit, do të trajtohen me të njëjtin standard.

Nuk ka cenim të karrierës së gjyqtarit sepse gjyqtari është në program vlerësimi 2017-2019. Në momentin kur do aplikojë, sipas dispozitave që kemi, do t'i bëhet një vlerësim i përshpejtuar të vitit të fundit 2022. Pra do të ketë edhe ai gjyqtar dy vlerësime si çdo gjyqtar tjetër. Por që për një gjyqtar të fillojë vlerësimi, duhet të ketë tre vite përvojë profesionale, se këtë gjë e thotë ligji dhe ky është standard për të gjithë gjyqtarët, jo vetëm për zotin {...}. Prandaj nuk ka as diskriminim dhe as mosrespektim të barazisë.

Ne gjithashtu kemi vlerësuar, që nëse gjatë kësaj periudhe trevjeçare do të ketë shkëputje, sigurisht që ato do të merren parasysh, por puna e tyre nuk mund të jetë më e pakët se 1 vit se ku do t'i gjejmë burimet e vlerësimit dhe si do ta vlerësojmë këtë gjyqtar, që me këtë vlerësim pastaj do shkojë të konkurrojë me një gjyqtar tjetër që e ka të plotë periudhën e vlerësimit; del edhe "Shkëlqyeshëm".

Prandaj unë vazhdoj t'i qëndroj propozimit për përfundimin e procedurës sipas vlerësimit.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim tjetër?

Kalojmë në votim sipas propozimit të relatores?

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e relatores.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin,

e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), e gjyqtarit {...}, për periudhën 2013–2016.

2. Kopje e vendimit i njoftohet zotit {...} sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3.Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.09.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:32 dhe mbaroi në orën 13:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Marçela Shehu dhe z. Dritan Hallunaj.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Staf administrativ i KLGJ-së; Këshilltarë dhe Media KLGJ.**
- 5. Katerina Çela.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër që ka të bëjë lidhur me refuzimin e kërkesës së znj. {...} për dhënie leje të papaguar.

(Anëtarët diskutojnë parimisht me njëri-tjetrin përpara trajtimit të çështjes.)

Naureda Llagami: Kalojmë pra tek çështja e radhës.

Fjalën ia jap zonjës Rupa për relatimin e projekt-aktit.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Do të paraqesë relacionin mbi projektvendimin e përgatitur nga Komisioni, që ka për objekt refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar.

Zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka paraqitur kërkesë për leje të papaguar për arsye familjare, në datën 23.08.2022.

Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron se në datën 29.10.2021, ka ardhur në jetë fëmija i saj i parë, i cili nuk ka mbushur ende 10 muaj. Gjatë kësaj periudhe, për rritjen dhe përkujdesjen e tij ka marrë lejen e lindjes, e cila i përfundon në datën 25.09.2022. Gjyqtarja parashtron se bashkëshorti i saj ushtron aktivitet privat të regjistruar si person fizik me objekt veprimtarie zhvillim software dhe ai aktualisht

ofron shërbime për kompaninë ndërkombëtare. Natyra e punës është e tillë që kërkon angazhimin e tij të vazhdueshëm, në orare të papërcaktuara paraprakisht në varësi të problemeve të çastit që mund të japin software-t e zhvilluara dhe/ose të monitoruara prej tij. Për rrjedhojë, ai e ka objektivisht të pamundur të kujdeset për fëmijën, qoftë dhe për intervale të shkurtra kohore.

Për këto arsye, referuar punës së bashkëshortit dhe pamundësisë së tij për të pezulluar përkohësisht, po ashtu dhe vështirësive për t'u koordinuar me orare me njëritjetrin në përkujdesjen për fëmijën, gjyqtarja ka kërkuar marrjen e lejes së papaguar për një periudhë prej 8 muaj, duke kërkuar mirëkuptimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për mbajtjen parasysh të interesit më të lartë të fëmijës.

Kërkesës me shkrim i është bashkëlidhur certifikata familjare, ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjekti person fizik, Raport për leje barrë lindje dhe faturë tatimore me nr.15/2022.

Me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtares {...}, u zhvillua procedura administrative, në përputhje me pikën VII të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” duke administruar kërkesën, aktet bashkëlidhur, të dhënat e vëna në dispozicion nga administrata e KLGJ-së dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Konkretisht, u administrua informacioni lidhur me statusin profesional të gjyqtares dhe funksionalitetin e gjykatës në të cilën ajo është emëruar.

Lidhur me statusin profesional të gjyqtares, nga informacioni i marrë nga dosja personale e gjyqtares, rezulton se ve vendimin nr. 505, datë 27.10.2020 ajo është caktuar në pozicionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Znj.{...} ka ushtruar efektivisht detyrën e gjyqtares, vetëm për 11 muaj, pasi në datën 27.09.2021 gjyqtarja ka përfutuar të drejtën e barrë lindjes, e drejtë kjo që përfundon në datën 26.09.2022. Në këto rrethana, znj. {...} rezulton se nuk ka më shumë se një vit pune të pandërprerë si gjyqtare.

Në lidhje me funksionalitetin e Gjykatës, zëvendëskryetari i gjykatës ka shprehur mendim lidhur me këtë kërkesë duke parashtruar se: “...pas konsultimit edhe me trupën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, çmoj se nëse pranohet kërkesa juaj për dhënien e lejes së papaguar për periudhën e kërkuara, cenohet funksioni me efikasitet dhe në kohë i gjykatës, kjo referuar numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë aktualisht detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe numrit relativisht i lartë i çështjeve që janë

për shqyrtim. Gjithashtu, referuar urdhrin të brendshme të gjykatës “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues” do të pasjellë shpërndarjen e trupit gjykues që gjyqtarja është caktuar, në kushtet kur dhe trupi gjykues ende nuk është formatuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve në këtë gjykatë”. Lidhur me ngarkesën aktuale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nga informacioni i përcjellë nga kancelarja e gjykatës, në datën 07.09.2022, rezulton se ngarkesa aktuale, në datën e përcjelljes së informacionit, është mesatarisht 187 çështje për gjyqtar.

Në lidhje me lejen prindërore neni 132/1 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “1. Punëmarrësi, i cili ka më shumë se një vit pune të pandërprerë tek i njëjti punëdhënës, ka të drejtë për një leje të papagueshme, jo më pak se 4 muaj, derisa fëmija që ka në ngarkim të arrijë moshën 6 vjeç. E drejta për të kërkuar lejen prindërore është individuale për secilin prind dhe nuk është e transferueshme, me përjashtim të rasteve kur njëri prind vdes. Leja mund të jepet e ndarë, por jo më pak se një javë në vit. Kohëzgjatja përcaktohet me marrëveshje me shkrim midis punëdhënësit dhe punëmarrësit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në të cilin përcaktohen kriteret për dhënien e tyre.

Lidhur me kushtet për dhënien e lejes prindërore, ky vendim parashikon se:

1. Leja prindërore i jepet nga Këshilli, gjyqtarit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë, në disa raste:

a. Për një periudhë jo më pak se 4 muaj dhe jo më shumë se dy vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim, të arrijë moshën 6 vjeç;

Ndër të tjera dispozita parashikon se:

ç. Gjyqtari që kërkon këtë leje, e paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje si dhe përcakton kohëzgjatjen e saj. Bashkë me kërkesën, gjyqtari paraqet dokumentacionin justifikues dhe mendimin me shkrim nga kryetari i gjykatës.

Në rast të cenimit të funksionalitetit apo përmbushjes së detyrës me efikasitet dhe në kohë, Këshilli mund të shtyjë datën e fillimit të lejes deri në 6 muaj.

Në lidhje me kushtet për dhënien e lejes për arsye familjare, po vendim parashikon:

Leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet, jepet nga Këshilli, si më poshtë:

a. Gjyqtari që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Në rast të nevojave urgjente kërkesa paraqitet menjëherë pa vonesë. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes dhe afatin e lejes së kërkuar. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës;

Ndër të tjera, dispozita parashikon se:

Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.

Në kërkesën e znj.{...} parashtruhet se kërkohet leje e papaguar për arsye familjare, por referuar përmbajtjes së kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, Komisioni vlerësoi dhe analizoi kriteret për të dy llojet e lejeve të papaguara, asaj prindërore dhe asaj për arsye familjare.

Duke e trajtuar kërkesën e gjyqtares, si kërkesë për leje prindërore, lidhur me plotësimin e kushteve si më sipër, rezulton se në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, gjyqtarja {...}, nuk ka ushtruar detyrën për të paktën një vit në mënyrë të pandërprerë (kusht ligjor i përcaktuar në nenin 132/1 të K.Punës dhe pika V e Rregullores së Këshillit). Për këtë shkak vlerësohet se nuk plotësohet kushti ligjor për përfitimin e lejes prindërore.

Para se të vlerësohen kushtet dhe kriteret e dhënies së lejes për arsye familjare, Komisioni vlerëson të evidentojë faktin se, në rastin konkret, pavarësisht se kërkesa objekt shqyrtimi rezulton të jetë kërkesë për leje prindërore, megjithëse nuk është specifikuar qartë nga gjyqtarja, këto dy lloje të lejes së papaguar aplikohen në raste të ndryshme dhe nuk janë alternativa të aplikimit mbi të njëjtat rrethana. Leja për arsye familjare nuk mund të përfshijë në të edhe lejen prindërore, e cila është një kategori specifike e parashikuar nga ligji (Kodi i Punës) dhe që mund të përfitohet nga çdo prind punëmarrës, pavarësisht profesionit që ai ushtron, nëse plotësohen kushtet ligjore të përfitimit të saj.

Referuar pikës VII të Vendimit nr. 72 datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” është parashikuar mundësia e refuzimit sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.

Dhënia e lejes për arsye familjare, ndërkohë që kërkesa në thelb i referohet lejes prindërore, nuk përmbush kushtet ligjore të përfitimit të saj, çka do të përbënte shkak për zbatim jo të njëjtë të dispozitave të aktit nënligjor në situata dhe ndaj subjekteve të ndryshëm.

Nëse kërkesa e gjyqtarës do të trajtohej si kërkesë për leje të papaguar për arsye familjare, kërkesa nuk përmbush kushtet ligjore të përfitimit të saj, në kushtet kur zëvendëskryetari i gjykatës ka shprehur mendimin e tij në lidhje me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, në rast miratimi të kërkesë për leje të papaguar. Njëkohësisht, nuk identifikohet asnjë rrethanë e posaçme që të përlligjë “nevojën familjare”, pasi nevoja për përkujdesje ndaj fëmijës së mitur përben shkak ligjor për kërkimin e “lejes prindërore” dhe jo asaj “familjare”.

Njëkohësisht, dhënia e lejes për arsye familjare, duke vlerësuar të drejtën për jetë private dhe familjare në proporcion me funksionalitetin e gjykatës me qëllim dhënien e drejtësisë në kohë, vlerësohet se do të dëmtonte në shkallë më të lartë funksionalitetin e gjykatës ku gjyqtarja ushtron funksionin e saj, sesa nevojat që gjyqtarja pretendon se e kanë diktuar, duke e trajtuar shkakun ligjor të ndryshëm për “lejen prindërore” nga “leja familjare”. Nuk identifikohet asnjë rrethanë e posaçme që të përlligjë “nevojën familjare”, pasi nevoja për përkujdesje ndaj fëmijës së mitur përben shkak ligjor për kërkimin e “lejes prindërore” dhe jo asaj “familjare”.

Referuar sa më sipër, Komisioni i propozon mbledhjes plenare:

1. Refuzimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për dhënie leje të papaguar për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 maj 2023.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Akti hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Rupa!

Atëherë, kalojmë, nëse nuk kemi diskutim, në miratimin e projekt-aktit, sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e relatores.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Refuzimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për dhënie leje të papaguar për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 maj 2023.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.09.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e automjeteve të reja dhe në përdorim, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:32 dhe mbaroi në orën 13:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Marçela Shehu dhe z. Dritan Hallunaj.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Staf administrativ i KLGJ-së; Këshilltarë dhe Media KLGJ.**
- 5. Katerina Çela.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e automjeteve të reja dhe në përdorim, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Tani kalojmë tek projekt-akti i radhës.

Bëhet fjalë për transferimin e automjeteve të reja dhe në përdorim në sistemin gjyqësor.

Ju jeni vënë në dijeni që me miratimin e projektbuxhetit që ne kishim programuar si KLGJ 4 automjete të reja për Gjykatën e Lartë, e cila është bërë e mundur që të realizohet marrja e këtyre katër mjeteve dhe që do i përcillen Gjykatës së Lartë; sikurse edhe një transferim të një automjeti të përdorur Mercedes Benz nga Gjykata e Lartë për nevojat që kërkon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Nëse doni detaje mbi mënyrën e transferimit, këtu kemi edhe drejtorin e departamentit.

Nëse jeni të qartë, atëherë do ju ftoja që të bëjmë votimin e projekt-aktit mbi transferimin e automjeteve.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e relatores.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e

ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Transferimin e 4 automjeteve të reja tip Scoda Octavia 2.0 naftë, viti 2022, pranë Gjykatës së Lartë.

2. Transferimin e 1 automjeti të përdorur tip Mercedes Benz, viti 2005, nga Gjykata e Lartë, te Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.09.2022)

Pika 5 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:32 dhe mbaroi në orën 13:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Marçela Shehu** dhe **z. Dritan Hallunaj**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Staf administrativ i KLGJ-së; Këshilltarë dhe Media KLGJ.*
5. *Katerina Çela.*

RENDI I DITËS:

5 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e fundit e cila ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Çështja që ne e përfshimë sot.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët me vendimin nr. 394, 21.09.2022, nga ana e Këshillit është proceduar me hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për një afat deri më datë 01.05.2023. Kjo shpallje i drejtohej gjyqtarës së transferuar aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë znj. {...}, e cila ftohej për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

Me datën 22.09.2022, me postë elektronike, gjyqtarja {...} ka paraqitur një deklaratë ku shpreh pëlqimin për vijimin e transferimit të përkohshëm, kështu që në bazë të nenit 46 të ligjit 96/2016, si dhe nenit 8 të vendimit nr.23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, KZHK-ja i kërkoi opinion zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me:

- ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi;
- pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit;
- si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtarja

kërkohe të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Me komunikimin elektronik po të datës 22.09.2022, me shkresën {...} zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dërguar informacionin e kërkuar si vijon:

Së pari, referuar kërkesës për informacion mbi ngarkesën e përgjithshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të cilën unë drejtoj është si më poshtë, duke paraqitur në formë tabelare ngarkesën respektive të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate, duke specifikuar që në këtë raportim nuk përfshihen çështjet ku gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë deleguar; ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sa më sipër u parashtrua për gjyqtarët, në total është 1766 çështje në gjykim.

Së dyti, lidhur me pasojat negative që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarës, dua të them se me aq gjyqtarë sa janë aktualisht në detyrë (8 nga 14 që ka organika) ngarkesa është e përballueshme, kuptohet me vështirësitë e veta por është e përballueshme në tërësi.

Problemi qëndron për muajt në vijim deri në shkrirjen e gjykatave në muajin qershor 2023 ku Gjykata e Pukës do t'i bashkohet asaj të Shkodrës, për shkak të ngjarjeve të pasigurta që mund të ndodhin, e konkretisht në faktin se nisur nga informacioni që unë kam si drejtues për shkak të korrespondencës me KPK-në, për tre nga gjyqtarët aktualë, procesi i rivlerësimit (Vettingut) është shumë afër përfundimit (raportit final) dhe së shpejti brenda këtij viti këta tre gjyqtarë mund të dalin në seancë dëgjimore përpara KPK-së, ku ekziston mundësia që të shkarkohen ose të konfirmohen në detyrë sipas rastit. Ndër të tjera, një tjetër gjyqtar z. Selimi pritet që në fund të muajit shkurt të vitit 2023 të dali në pension.

Në këto kushte sa më sipër duke u varur nga ngjarje të pasigurta që mund të ndodhin në vijim si dhe mosdijeninë e kohës konkrete se kur mund të vërtetohen këto fakte, e kam të pamundur t'ju jap një propozim konkret mbi kohëzgjatjen maksimale për të cilën gjyqtaria {...} mund të transferohet përkohësisht.

Sa më sipër, dua të them se në qoftë se situata vazhdon në vijim njëloj sikur është edhe sot me 8 (tetë) gjyqtarë, atëherë efektet negative të shkaktuara nga ky transferim do të ishin minimale dhe mendimi im shkon në favor të vazhdimit të transferimit të përkohshëm, të gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë të paktën deri në muajin mars të vitit 2023.”

Në vijim Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duke marrë në konsiderate që nuk mund të aplikohet zbatimi i neneve 45 dhe 46 të Ligjit nr.96/2016, pasi verifikoi edhe plotësimin e kriterëve të kandidaturës që ka dhënë pëlqimin për transferim e përkohshëm, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarës që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organiken aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistencën e pozicionit të lira të përkohshëm në të, ngarkesën aktuale Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ku ajo është caktuar në mënyrë të përhershme, përfundimin e afatit të transferimit të përcaktuar me Vendim nr. 363, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju propozon për të miratuar projektvendimin, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet:

1. Gjyqtarës {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, për një periudhë deri më datë 01.05.2023.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 26.09.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, për një periudhë deri më datë 01.05.2023.

2. Efektet e vendimit fillojnë nga data 26.09.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Edhe një njoftim të vogël. Ndërkohë që stafi po përgatit një projekt-akt për sa i përket delegimit në gjykatat që janë në nevojë, ndërpresim mbledhjen për t'u rilidhur prapë për shqyrtimin e këtij projekt-akti.

* * *

(Pika 5 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor